



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL DURRËS

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall
(Procedurë e Hapur- Mall) mbi kufirin e larte monetar

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELLORE”

VLERA E FONDIT LIMIT: 17.777.820 (*shtatëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzet*) lekë, pa TVSH

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Panele diellore 09331000-8

AFATI I LËVRIMIT : 2 (dy) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros të realizuara nga operatori ekonomik për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 10 % e vlerës së përllogaritur të fondit të limit të kësaj kontrate

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimit të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 40, pika 4 dhe neni 47, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 10 % e vlerës së përllogaritur të fondit të limit të kësaj kontrate, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh

ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Certifikim i Operatorit Ekonomik për realizimin e projektit.

Për plotesimin e kësaj kërkesë ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën ose ekuivalente e kërkuara për :

- ISO 14001:2015: Sistemi i Menaxhimit Mjedisor - e vlefshme **ose ekuivalente**
- ISO 50001:2018: Sistemi i Menaxhimit të Energjisë - e vlefshme **ose ekuivalente**

(Certifikatat duhet të jete të leshuara nga organizmat e vleresimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Duke qene se sistemi pjese e prokurimit eshte e rendesishme per sigurine dhe vijueshmerine e punes te sistemeve kritike ne APD duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- Përmbushja e standartit **ISO 50001:2018** siguron që operatorët ekonomikë të kenë një sistem të menaxhimit të energjisë që rrit efikasitetin dhe optimizon përdorimin e saj. Kjo ndihmon në maksimizimin e prodhimit nga panelet dhe uljen e kostove operative. Kjo është një ISO e rëndësishme në projekte që lidhen me teknologji apo sisteme energjetike.
- Përmbushja e standartit **ISO 14001: 2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që Operatori Ekonomik është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës, duke garantuar menaxhimin e mjedisit. Kjo ISO siguron që operatorët ekonomikë të respektojnë standardet mjedisore, të menaxhojnë mbetjet dhe të minimizojnë ndotjen gjatë instalimit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt i kontratës, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, me kategoritë e mëposhtme:

- NP –10 A “Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike”

Argumentimi:

Kërkesa për paraqitjen e licencës profesionale të vlefshme, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në VKML nr. 42, datë 16.01.2008, synon të garantojë se operatori ekonomik që merr përsipër realizimin e kontratës zotëron kapacitetin teknik, profesional dhe ligjor për të kryer punimet që janë objekt i saj.

Licenca NP–10 A (“Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike”) është kategoria specifike që mbulon saktësisht fushën e punimeve të kontratës, që përfshijnë ndërtimin e impianteve prodhuese të energjisë elektrike — siç mund të jenë HEC-e, TEC-e, parqe fotovoltaike, etj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi, në përputhje me Rregulloren e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 943, datë 28.12.2016, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

- *Kategoria 3.d* – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe përforcimi i strukturave mbajtëse prej betoni arme, murature dhe metalike;
- *Kategoria 4.c* – Projektim i linjave dhe rrjeteve elektrike për objekte civile dhe industriale;
- *Kategoria 10.c* – Projektim i impianteve të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, si dielli, era etj.
- *Kategoria 10.e* – Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, (projektim & zbatim) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi:

Kjo kërkesë është e arsyetuar sepse:

- Siguron cilësi teknike të dokumentacionit të projektimit, e cila është bazë për një zbatim të saktë dhe të sigurt të punimeve ndërtimore.
- Mbështet transparencën dhe barazinë në garë, pasi vendos një standard profesional minimal të detyrueshëm për të gjithë operatorët ekonomikë.
- Përputhet me legjislacionin sektorial në ndërtim, i cili kërkon që çdo projekt i ndërtimit të realizohet nga subjekte të licencuara për projektim.
- Redukton riskun për autoritetin kontraktor nga projekte joprofesionale që mund të sjellin defekte në zbatim, pasoja financiare apo ligjore.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar jo me pak se 10 punonjes ne listepagese, nga te cilet te pakten:

- 1 (nje) punonjes si inxhinjer Elektronik/Informatik/Kompjuterik/Telekomunikacioni duhet te jene te diplomuar,
- 1 (një) punonjes si Inxhinjer Elektrik i diplomuar,
- 1 (nje) punonjes si Inxhinjer Mekanik te diplomuar
- 1 (një) punonjes si Inxhinjer Ndërtimi i diplomuar.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: diplomat dhe vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes se ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG te raportuara ne zyrat e tatim taksave.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, që lejon autoritetet kontraktore të vendosin kriteret mbi kapacitetin teknik dhe profesional, për sa kohë ato janë reale, proporcionale, jo diskriminuese dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Në këtë rast, kriteri plotëson të gjitha këto kushte dhe është i domosdoshëm për garantimin e cilësisë së zbatimit. Ky kriter është i nevojshëm që Operatorët pjesëmarrës të provojnë besueshmërinë dhe provojnë e tyre në realizimin e kontratës pa vonesa dhe pengesa, që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) inxhinier Elektronik/Elektrik trainuar dhe certifikuar nga Prodhuesi per Sistemet e Menaxhimit te Energjise per produktet qe ofertoohen. Per kete duhet te paraqese certifikaten perkatese. Punonjesi duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per 3 muajt e fundit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkripteve përkatëse. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi:

Në projekte ndërtimi, energjie apo teknologjie, certifikimi siguron që vendimet teknike merren nga persona të kualifikuar, duke reduktuar rrezikun e gabimeve që mund të shkaktojnë dëme materiale apo njerëzore.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, që i lejon autoritetet kontraktore të kërkojnë dëshmi të kapaciteteve teknike dhe profesionale, për sa kohë ato janë të nevojshme për realizimin korrekt të kontratës. Në këtë rast, kriteri është legjitim, proporcional dhe i lidhur ngushtë me natyrën teknike të kontratës

- 2.3.7** Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) inxhinier Elektronik/Elektrik trainuar dhe certifikuar nga Prodhuesi për Ndërtimin e Sistemeve të integruara. Për këtë duhet të paraqesë certifikatën përkatëse. Punonjësi duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkripteve përkatëse. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi:

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë minimalisht një inxhinier Elektronik/Elektrik të trajnuar dhe certifikuar nga prodhuesi për ndërtimin e sistemeve të integruara është thelbësore për garantimin e cilësisë dhe funksionalitetit të pajisjeve të instaluar.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, që lejon vendosjen e kriterëve mbi kapacitetin teknik dhe profesional, për sa kohë ato janë të domosdoshme, të qarta dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Në këtë rast, kriteri siguron që zbatimi të bëhet nga personel i kualifikuar, i trajnuar dhe i verifikueshëm, duke mbrojtur cilësinë e investimit publik.

- 2.3.8** Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) inxhinier Elektronik/Elektrik trajnuar dhe certifikuar nga Prodhuesi për Sistemet e Menaxhimit të Ndërtësive për produktet që ofertohen. Për këtë duhet të paraqesë certifikatën përkatëse. Punonjësi duhet të figurojë në listëpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatimit taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkriptëve përkatëse. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi:

Kërkesa që operatori ekonomik të ketë minimalisht një inxhinier për produktet që ofertohen është e domosdoshme për të garantuar një implementim profesional dhe në përputhje me standardet e prodhuesit. Këto sisteme janë komplekse dhe kërkojnë njohuri të avancuara teknike për konfigurim, integrim dhe mirëmbajtje.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, që lejon vendosjen e kriterëve mbi kapacitetin teknik dhe profesional, për sa

kohë ato janë të domosdoshme, të qarta dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Në këtë rast, kriteri siguron që zbatimi të bëhet nga personel i kualifikuar, i trajnuar dhe i verifikueshëm, duke mbrojtur cilësinë e investimit publik.

- 2.3.9** Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 2 (dy) eletriçiste. Për këtë, duhet të paraqesë certifikatën perkatese. Punonjësi duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkriptëve perkatese. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, i cili lejon kërkesa mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë të nevojshme për realizimin korrekt të kontratës. Në këtë rast, kërkesa është legjitime, e nevojshme dhe e drejtë, duke siguruar që punimet elektrike të kryhen nga persona të kualifikuar dhe ligjërish të autorizuar.

- 2.3.10** Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) ekspert zjarrfikës. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, punonjësi duhet të paraqesë licencën perkatese dhe duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit .

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Gjatë zbatimit të instalimit të paneleve diellore, prania e një eksperti zjarifikës është thelbësore për të siguruar që punimet të zhvillohen në përputhje me masat e mbrojtjes nga zjarri. Panelet diellore dhe komponentët e tyre (inverterë, kabllime, lidhje elektrike) përbëjnë rrezik potencial për ndezje ose mbingarkesë nëse nuk trajtohen sipas standardeve.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, i cili lejon kërkesa mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë të nevojshme për realizimin korrekt të kontratës. Gjithashtu ky kriter është në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.” Një ekspert i kualifikuar mund të identifikojë rreziqet e mundshme të zjarrit në kantier dhe të marrë masa për t'i zbutur ato. Ky proces përfshin hartimin e planeve të evakuimit dhe emergjencës, si dhe implementimin e sistemeve dhe pajisjeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve.

- 2.3.11** Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) punonjes të certifikuar për punimet në lartësi. Punonjesi duhet të figurojë në listepagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkripteve perkatese. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje të noterizuar:

Argumentimi:

Punimet në lartësi (si montimi i paneleve në çati) përbëjnë një nga aktivitetet më të rrezikshme në ndërtim. Certifikimi siguron që punonjësi është trajnuar për të njohur dhe menaxhuar këto rreziqe.

Legjislacioni shqiptar dhe direktivat e BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë kërkojnë që punonjësit në kushte të rrezikshme të jenë të trajnuar dhe të certifikuar.

Në rast aksidenti, mungesa e një punonjësi të certifikuar mund të sjellë pasoja ligjore për operatorin ekonomik dhe institucionin kontraktues.

Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c)

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, i cili lejon kërkesa mbi kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë të nevojshme për realizimin korrekt të kontratës. Në këtë rast, kërkesa është legjitime, e nevojshme dhe e drejtë, duke siguruar që punimet elektrike të kryhen nga persona të kualifikuar dhe ligjërisht të autorizuar.

- 2.3.12** Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 1 (një) punonjes i pajisur me certifikatë për “Përgjegjësinë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me Ligjin nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores ‘Për sigurinë në kantier’”, shoqëruar me, certifikatën përkatëse dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë sipas periudhës së kërkuar;

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: Certifikatat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo do të vërtetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatim taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nepermjet transkripteve përkatëse. Një person mund të disponojë një ose me shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Ky kriter është ligjërisht i detyrueshëm dhe teknikisht i domosdoshëm për të garantuar mbarëvajtjen e punimeve në kushte sigurie, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar për sigurinë në punë. Është gjithashtu e bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/ç), 40, pika 5/b,c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si një kërkesë mbi kapacitetin teknik që ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe mbrojtjen e interesit publik.

- 2.3.13** Operatori ekonomik duhet të ketë 2 (dy) punonjes instalator të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente të licensuara.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: kartelat e personelit, vërtetimet nga zyrat tatimore që personeli i mësipërm ka një marrëdhënie pune të paktën 3 muaj nga data e hapjes së ofertave me ofertuesin. Kjo

do të vertetohet nga deklaratimet E_SIG të raportuara në zyrat e tatimit të taksave. Certifikatat e ngarkuara duhet të jenë të vlefshme dhe të verifikueshme online në mënyrë direkte, ose nëpërmjet transkriptive perkatese. Një person mund të disponojë një ose më shumë certifikime.

Ky kriter përmbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Ofertuesi i kualifikuar, i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit për të dëshmuar disponimin e tyre duhet të paraqesë dokumentacionin provues origjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi:

Pajisja me kartelë sigurimi teknik vërteton që punonjësit janë të kualifikuar profesionalisht dhe të verifikuar për punime në instalime elektrike, mekanike apo sisteme të tjera teknike, sipas standardeve kombëtare. Kjo masë parandaluese ndihmon në shmangien e defekteve, aksidenteve dhe rreziqeve gjatë zbatimit, duke rritur besueshmërinë dhe përgjegjshmërinë teknike të operatorit.

Kjo kërkesë është e domosdoshme për të garantuar sigurinë teknike në zbatim, përputhet me legjislacionin në fuqi mbi pajisjet dhe instalimet teknike, dhe nuk përbën pengesë të pajustificuar për konkurrencën. Ajo garanton që operatori zotëron kapacitet njerëzor të kualifikuar për të përmbushur punimet në përputhje me standardet e sigurisë industriale.

2.3.14 Operatori Ekonomik ofertuese duhet të jetë i autorizuar për furnizimin dhe suportin për pajisjet e ofruara, për këtë duhet të paraqesin. Autorizimin nga prodhuesi / Distributori i autorizuar nga prodhuesi (në rastin e distributorit të autorizuar duhet të paraqitet dokumenti që vërteton lidhjen midis Prodhuesit dhe distributorit) për furnizimin dhe suportin në territorin e Shqipërisë të pajisjeve:

- Sistemin EMS dhe BMS
- Inverter
- Panele Fotovoltaike

Argumentim: Autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për territorin e Shqipërisë për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanton që produktet që kërkohen të blihen janë prodhuar/krijuar sipas standardeve të larta nga prodhuesi i njohur zyrtarisht. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen dhe suportin e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e pajisjeve në kushtet e garancisë dhe pas

2.3.15 Oferte Teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për mallrat e listes në formatin e **Ofertes Teknike**, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.16 Në menyre që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Arsyetimi për mos ndarjen e kontratës në lote.

Objekti i kontratës “ZBATIMI I PLANIT PILOT: BLERJA DHE INSTALIMI I PANELEVE DIELORE” përbën një sistem të integruar teknik, ku të gjitha komponentët (panelet, inverterët, strukturat mbajtëse, kabllot, pajisjet mbrojtëse dhe sistemet e monitorimit) janë të ndërvarura funksionalisht. Ndarja në lote do të sillte rrezik për papajtueshmëri ndërmjet komponentëve, vështirësi në koordinimin teknik dhe përgjegjësi të shpërndarë për performancën e sistemit. Për më tepër, kjo do të çenonte garancinë unike të funksionimit dhe efikasitetin ekonomik të projektit.

Fragmentimi në lote do të sillte rrezik për mbivendosje përgjegjësish, mungesë koherence në zgjidhjen e problemeve dhe vonesa në reagim. Për më tepër, një kontratë e pandarë lejon që të ruhet konsistenca në cilësinë e objektit të kësaj kontrate. Ajo mundëson një komunikim të drejtpërdrejtë dhe të qartë mes palëve, si dhe eviton çdo keqkuptim apo vonesë që mund të lindë në rast të koordinimit mes ofruesve të ndryshëm.

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

A. Në fazen e pranimit, janë të detyruar të paraqesin;

1. **Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstrohet, se sherbimet jane kryer paraqitura ne dokumentet e ofertimit.
2. **Dokumente origjinale** ose te njevlefshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstrohet produktet e ofruara

VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA

AUTORITETI KONTRATOR, rezervon te drejten të kryeje, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, per tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve te kerkuara.

III. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për mallrat dhe shërbimet e kërkuara duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike janë vendosur në përputhje me nevojat e institucionit për të garantuar funksionimin dhe arritjen e qellimeve te percaktuara.

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme e saktë e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT